

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA LAÇI KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 28142/17)

VENDIM

Neni 6§1 (civil) – Mosvlerësimi i vazhdueshëm nga ana e gjykatës vendëse i së drejtës për t'u përjashtuar nga taksa e akteve, duke cenuar thelbin e së drejtës për akses në gjykatë – Të meta në funksionimin e Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike dhe dominimi i mosdashjes nga ana e gjyqtarëve për të bërë përjashtime nga taksa e akteve, sipas konstatimeve nga organet monitorues të Këshillit të Evropës

STRASBURG
19 tetor 2021

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë në përputhje me rrethanat e parashikuara në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Laçi kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur si Kolegj, i përbërë nga:

Georges Ravarani, *kryetar*,

Georgios A. Serghides,

Maria Elósegui,

Darian Pavli,

Anja Seibert-Fohr,

Peeter Roosma,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistare e Seksionit*,

Duke marrë në konsideratë:

Kërkesën (nr. 28142/17) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur më 3 prill 2017 nga shtetasi shqiptar z. Mustafa Laçi, pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa);

Vendimin për të njoftuar qeverinë e Shqipërisë (Qeveria) për kërkesën;

Vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 28 shtator 2021;

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me mosshqyrtimin në vijimësi nga ana e gjykatave vendëse të së drejtës së kërkesit për t'u përjashtuar nga taksa e padisë, si rezultat i së cilës nuk ka nisur ende shqyrtimi i kësaj padie për dëmshpërblim, sipas meritave të çështjes, duke përbërë në këtë mënyrë një kufizim të së drejtës së tij për akses në një gjykatë.

FAKTET

2. Kërkuesi ka lindur në vitin 1968 dhe jeton në Kavajë. Ai u përfaqësua nga z. D. Matlija dhe z. T. Alexandridis, avokatë të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në Tiranë.

3. Qeveria u përfaqësua nga agjentja e saj në atë periudhë, znj. E. Muçaj, dhe, më pas, nga znj. B. Lilo, nga Avokatura e Shtetit.

4. Faktet e çështjes, sipas parashtrimeve të palëve mund të përmbliidhen, si më poshtë:

1. PROCEDIMET NË LIDHJE ME PADINË E KËRKUESIT PËR DËMSHPËRBLIM

5. Më 21 shkurt 2011, kërkuesi dhe shtatëdhjetë persona të tjerë paraqitën padi ndaj Ministrisë së Mbrojtjes dhe shtetit, ku kërkonin kompensim (pa përcaktuar shumën) për dëm monetar dhe jomonetar për humbjen e jetës së familjarëve të tyre gjatë një shpërthimi në një objekt për çmontimin e municionit, menaxhimin e të cilit autoritetet ua kanë dhënë kompanive private.

6. Më 27 janar 2021, Gjykata e Rrethit Tiranë i ndau paditë për dëmshpërblim. Më 20 janar 2014, kërkuesi pagoi një shumë fikse për taksën e padisë prej 12,000 ALL (rreth 98 euro), sipas rregullave të brendshëm (shih paragrafin 22 më poshtë). Më 28 shkurt 2014, gjykata u vetëshpall jokompetente për shqyrtimin e padisë së kërkuesit, duke pasur në konsideratë krijimin dhe veprimtarinë e gjykatave administrative, dhe vendosi t'ia referonte çështjen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (Gjykata e Shkallës së Parë). Shuma e kompensimit të pretenduar ishte 32,000,000 ALL (rreth 228,000 euro), dhe taksa e padisë që duhej të paguhej ishte 3 për qind i kësaj shume, që është 960,000 ALL (rreth 6,840 euro).

7. Më 6 janar 2015, kërkuesi, i cili ishte i papunë dhe jetonte me një pension mujor prej 8,000 ALL (rreth 57 euro), i kërkoi Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike (KSHNJ) një formular aplikimi për të kërkuar ndihmë juridike, në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së padisë, për shkak të varfërisë së tij. Kërkesa nuk mori përgjigje.

8. Në vijim të kërkesës së kërkuesit për t'u përjashtuar nga taksa e padisë, Gjykata e Shkallës së Parë, e rrëzoi këtë kërkesë gjatë një seance paraprake, në mbështetje të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC) për moskorrigjimin e të metave të padisë. Më 20 nëntor 2014, përfaqësuesi i kërkuesit kërkoi një reduktim të shumës së kompensimit të pretenduar. Nuk rezulton që gjykata ta ketë shqyrtuar këtë kërkesë.

9. Më 20 janar 2015, Gjykata e Shkallës së Parë ia ktheu padinë kërkuesit pa ndërmarrë asnjë veprim, duke deklaruar se ai nuk kishte korrigjuar të metat e padisë, më konkretisht shlyerjen e plotë të taksës së padisë dhe tarifave të ekspertit, brenda afatit të përcaktuar. Më tej, gjykata parashitroi se ligji për taksën në fjalë nuk parashikonte në mënyrë eksplicite përjashtimin nga pagesa e taksës së padisë dhe tarifave për ekspertët, edhe pse me anë të paraqitjes së dokumenteve mbështetëse, kërkuesi kishte treguar se nuk mund të shlyente taksën e padisë. Më 26 janar 2015, kërkuesi apeloj këtë vendim.

10. Më 21 dhjetor 2017, Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë (Gjykata Administrative e Apelit) e prishi vendimin dhe e ktheu çështjen në Gjykatën e Shkallës së Parë, duke rekomanduar që: të përcaktohej vlera e padisë dhe shuma e taksës së padisë që do të duhej të paguhej; të merrej një vendim i ndërmjetëm ku të përcaktohej se cila palë do të paguante kostot; dhe të orientohej kërkuesi që të kërkonte ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së padisë, në mbështetje të ligjit për ndihmën juridike të vitit 2008. Në rast të një refuzimi apo të një mospërgjigjeje nga ana e KSHNJ-së, Gjykata e Shkallës së Parë do të duhej të vihej në lëvizje dhe të vlerësonte nëse kërkuesi ishte i klasifikueshëm për marrjen e ndihmës juridike, në përputhje me nenin 21(1) dhe (2) dhe nenin 13(1)(c) të ligjit për ndihmë juridike të vitit 2008. Nëse Gjykata e Shkallës së Parë arrinte në përfundimin se kërkuesi nuk përmbushte kërkesat statutores për të përfituar ndihmë juridike, ajo mund ta kthente padinë për mospagim të taksës së padisë, në përputhje me nenet 25(a) dhe 21(1) të ligjit për gjykatat administrative. Nga ana tjetër, mosshlyerja e tarifave të ekspertëve nuk përbënte arsye për ta konsideruar padinë me të meta, sepse gjykata mund të lëshonte një urdhër për nxjerrjen e detyrueshme të shpenzimeve, në përputhje me nenin 105 të KPC-së (shih paragrafin 17 më poshtë).

11. Më 22 janar 2018, Ministria e Mbrojtjes, e cila ishte në cilësinë e të paditurit gjatë procedimeve, paraqiti një ankesë në Gjykatën e Lartë, për të cilën rezultoi se procedimet janë ende pezull. Ankesa nuk kundërshtonte mungesën e mjeteve financiare të kërkuarit, por theksonte se Gjykata e Shkallës së Parë kishte interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte dispozitat përkatëse në lidhje me kërkesën e tij për përjashtim.

II. SHKRESA E AUTORITETEVE PËR KËRKUESIN

12. Në vijim të rezultatit të padisë së kërkuarit për dëmshpërblim përpara Gjykatës së Shkallës së Parë, më 19 shkurt 2015, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë (Ministria) informoi avokatin e kërkuarit (në lidhje me një çështje tjetër), se ende nuk ishte përgatitur një formular aplikimi për të kërkuar përjashtim nga taksa e padisë dhe se do të duhej të miratoheshin një sërë aktesh rregullatorë përpara se KSHNJ-ja të mund ta ofronte një formular të tillë. Gjithashtu, Ministria shpjegoi se KSHNJ-ja, në disa raste, mund ta shtynte shlyerjen e taksës së padisë ose të lejonte që pagesa të bëhej në disa këste. Së fundmi, Ministria deklaronte se në mungesë të një vendimi nga KSHNJ-ja, brenda dhjetë ditëve, gjykata përkatëse mund të ofronte ndihmë juridike në një nga format e parashikuara nga ligji, në rast se përmbusheshin kërkesat statutores.

KUADRI DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME

A. Kodi i Procedurës Civile (KPC)

13. Neni 104, i cili u shfuqizua në vitin 2017, parashikonte se taksa mbi aktet përcaktohej bazuar në vlerën e padisë, e cila paraqitej nga paditësi. Megjithatë, vetë gjykata mund të përcaktonte vlerën e padisë, nëse kishte dyshime të qarta për shumën e përcaktuar nga paditësi, i cili, si rregull, kishte përgjegjësinë të paguante taksën e akteve.

14. Neni 105(b), i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2001, parashikon se individët, të cilët përjashtohen nga pagesa e taksës së akteve, do të përjashtohen nga pagesa e kostove dhe e shpenzimeve të tjera.

15. Sipas neneve 102 dhe 156, taksa e akteve duhet të paguhet në momentin, kur paraqitet një padi. Në rastin kur kjo taksë nuk paguhet, një gjyqtar i vetëm e kthen padinë te paditësi pa ndërmarrë asnjë veprim tjetër, në mbështetje të nenit 154(a), duke përcaktuar korrigjimin e të metave brenda afatit kohor të parashikuar. Ndaj këtij vendimi mund të paraqitet një ankesë e posaçme.

16. Sipas nenit 158(a), gjykata, në një seancë paraprake, mund të vendosë për përjashtimin e paditësit nga pagesa e taksës së akteve në çështjet e parashikuara nga ligji. Në një rast të tillë, neni 106 parashikon se tarifat gjyqësore do të mbulohen nga i pandehuri deri në masën e përcaktuar nga gjykata.

17. Sipas nenit 105, tarifat gjyqësore duhet të paguhet paraprakisht nga pala, e cila kërkon një raport të ekspertëve. Megjithatë, gjykata mund të urdhërojë palën tjetër të paguajë tarifat për ekspertët ose mund të urdhërojë që këto tarifa të ndahen midis të gjitha palëve në procedim, nëse një gjë e tillë kushtëzohet nga rrethanat e çështjes dhe nga situata financiare e palëve.

B. Ligji për gjykatat administrative

18. Neni 25 i ligjit për gjykatat administrative parashikon se gjyqtari kryesues ndërmerr një sërë veprimesh brenda shtatë ditësh nga data e paraqitjes së padisë, të tilla si: kërkesa që i bëhet paditësit për të plotësuar mungesat në padi brenda dhjetë ditëve, të vendosë për paraqitjen e një raporti të përgatitur nga ekspertët, në rastin kur ka nevojë për informacione specifike, si edhe një sërë veprimesh të tjera të parashikuara në nenin 158(a) të KPC-së. Këto veprime ndërmerren me anë të vendimeve të ndërmjetme. Mosmarrja pjesë e palëve në veprimet paraprake nuk përbën shkak që çështja të pushohet, edhe nëse palët thirren dhe njoftohen rregullisht.

C. Ligji për ndihmën juridike i vitit 2008, i ndryshuar (ligji nr. 10039 i datës 22 dhjetor 2008, i ndryshuar me ligjet nr. 143/2013 dhe 77/2014)

19. Ligji për ndihmën juridike i vitit 2008 ishte në fuqi deri më 1 qershor 2018, kur u shfuqizua nga ligji për ndihmën juridike i vitit 2017 (ligji nr. 111 i datës 14 dhjetor 2017). Neni 11 parashikon dy lloje të ndihmës juridike: ndihma juridike parësore (që ka të bëjë me informacionet për legjislacionin dhe sistemin ligjor, të drejtat dhe detyrimet e individëve, dhe ndihmën për hartimin e dokumenteve ligjore), dhe ndihma juridike dytësore (që ka të bëjë me këshillimin ligjor dhe përfaqësimin në procedimet penale, civile dhe administrative). Sipas nenit 12, i cili u ndryshua në vitin 2013, ndihma juridike falas mund të ofrohet edhe në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së akteve dhe nga kostot dhe shpenzimet e tjera.

20. Ligji për ndihmën juridike i vitit 2008 parashikonte themelimin e KSHNJ-së, i cili ishte përgjegjës, midis të tjerash, për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike (nenet 6 dhe 10). Sipas nenit 16(4) dhe (6), ndryshuar në vitin 2014, kërkesat për ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së akteve duhej të bëheshin duke përdorur një formular të posaçëm për aplikim. neni 21(1), i cili hyri në fuqi në vitin 2013, parashikonte se KSHNJ-ja do të duhej t'i shqyrtonte kërkesat për ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga tarifa e taksës së akteve brenda dhjetë ditësh nga dita e marrjes së kërkesës. Nëse KSHNJ-ja nuk merrte një vendim ose e rrëzonte kërkesën, gjykata, në një seancë paraprake, do të mund të vendoste për përjashtimin e paditësit nga tarifa e taksës së akteve dhe nga kostot dhe shpenzimet e tjera, në rast se përmbusheshin kushtet sipas nenit 13(1)(c). Nëse KSHNJ-ja vendoste se paditësi nuk kishte mundësi të paguante taksën e akteve, për shkak të situatës së tij ose të saj financiare, KSHNJ-ja mund të urdhëronte që pagesa të shtyhej ose të bëhej me këste, edhe kur nuk përmbusheshin kushtet e parashikuara në nenin 13(1).

21. Neni 13(1)(c), i ndryshuar në vitin 2014, parashikonte se një person mund të përfitonte ndihmë juridike falas, nëse ai ose ajo nuk kishte mjete financiare të mjaftueshme për të paguar taksën e akteve, dhe ishte përfitues i ndihmës sociale ose përmbushte kërkesat për ta marrë një ndihmë të tillë, ose ishte viktimë e dhunës në familje ose e trafikimit njerëzor.

D. Ligji për taksat kombëtare (ligji nr. 9975 i datës 28 korrik 2008, i ndryshuar)

22. Ligji për taksat kombëtare parashikon, midis të tjerash, llojet e taksave dhe të tarifave të zbatueshme në vend, si edhe procedurat për përlogaritjen e tyre. Neni 11 parashikonte pagesën e tarifave të shërbimit, të tilla si tarifat gjyqësore, të cilat do të përcaktoheshin me anë të një urdhri të përbashkët të ministrit të Financave dhe të autoriteteve përkatëse shtetërore. Sipas nenit 11, një udhëzim për një praktikë të përbashkët nga ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave (udhëzimi nr. 13, i datës 12 shkurt 2009), i ndryshuar në vitin 2010, parashikonte se taksa e akteve për një padi për dëmshpërblim të vlerës, e cila ishte më pak se 100,000 ALL (rreth 714 euro), ishte 12,000 ALL. Nëse vlera e padisë kalonte vlerën 100,000 ALL, taksa e aktit do të ishte 3% e shumës së pretenduar.

23. Në vitin 2010, hyri në fuqi një dispozitë e re statutore, e cila parashikonte përjashtimin nga shlyerja e disa tarifave të shërbimeve për kategori të caktuara individësh (ligji nr. 10280, i datës 20 maj 2010). Megjithatë, nuk kishte asnjë dispozitë për përjashtimin nga tarifat gjyqësore.

E. Praktika gjyqësore e brendshme

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013

24. Në datë 27 shkurt 2013, përpara miratimit të ndryshimeve të viteve 2013 dhe 2014 në ligjin për ndihmën juridike, Gjykata Kushtetuese vendosi me shumicë se respektimi i kërkesës sipas ligjit vendës për shlyerjen e taksës së akteve në kohën e paraqitjes së padisë, edhe nga personat pa mjete financiare, nuk përbënte një shkelje të së drejtës së individit për akses në gjykatë. Ajo theksonte, se një paditës, i cili paraqiste një padi kërkohej që të paguante paraprakisht tarifën e akteve, si një përqindje e vlerës së padisë. Një gjyqtar i zakonshëm, në referim të rrethanave të çështjes dhe të situatës financiare të paditësit, mund të vendoste, rast pas rasti, ta përjashtonte atë nga detyrimi për të paguar taksën e akteve për të garantuar respektimin e së drejtës për akses në gjykatë. Në një rast të tillë, taksa e akteve do të paguhej nga buxheti i shtetit. Në vijim, Gjykata Kushtetuese përcaktonte se

KSHNJ-ja do të duhej të ofronte ndihmë juridike për kategori të caktuara individësh, në përputhje me ligjin për ndihmën juridike të vitit 2008.

25. Opinioni kundërshtues përcaktonte se ishte shkelur e drejta e individit për akses në gjykatë, duke iu referuar kërkesës për të paguar taksën e akteve, sepse legjislacioni i brendshëm nuk parashikonte përjashtim nga pagesa e taksës së akteve për personat pa mjete financiare. Në të nënvizohej, se kërkesa për të paguar taksën e akteve ishte *sine qua non* për vijueshmërinë e procedimeve. Gjithashtu, nënvizohej se interpretimi që u bënte shumica parashikimeve të KPC-së dhe ligjit për ndihmën juridike linte hapësirë për arbitraritet në mungesë të një kuadri të qartë ligjor për kriteret për përjashtim nga taksa.

2. Vendimet e gjykatave më të ulëta

26. Në vërejtjet e paraqitura me shkrim, Qeveria parashittoi vendimet e mëposhtme të gjykatave vendëse për përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore. Më 26 mars 2015, në një çështje të ngjashme për dhënien e dëmshpërblimit monetar dhe jomonetar për humbjen e jetës së familjarëve të paditësve, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, pasi shqyrtoi pretendimin për dëmshpërblim, në mbështetje të meritave të çështjes, vendosi se taksa e akteve dhe kostot dhe shpenzimet të paguara nga paditësit me paraqitjen e padisë, do të mbuloheshin nga të paditurit, të cilët ishin organe shtetërore, në mbështetje të – *inter alia* – neneve 102 dhe 106 të KPC-së.

27. Më 18 tetor 2018, në një seancë paraprake gjatë procedimeve, në lidhje me një padi për pagesën e dëmshpërblimeve monetare dhe jomonetare, gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë pranoi kërkesën për përjashtimin nga taksa e akteve, për shkak të varfërisë së të paditurit, sipas neneve 104 dhe 158(a) të KPC-së.

28. Më 25 shtator 2019, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi kërkesën për ndihmë juridike në formën e përfaqësimit në procedimet civile, sipas ligjit për ndihmën juridike 2017, sepse pensioni mujor (që merrej për shkak të moshës) i të paditurit ishte më i ulët se sa të ardhurat minimale mujore të përcaktuara nga Qeveria.

29. Më 1 nëntor 2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë pranoi kërkesën e paditësit për përjashtim nga taksa e akteve, sepse ai përmbushte kërkesat statutores në mbështetje të ligjit për ndihmën ligjore të vitit 2017, duke qenë se të ardhurat e tij ishte një pension për aftësi të kufizuara.

30. Më 23 dhjetor 2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë pranoi kërkesën për ndihmë juridike në formën e përfaqësimit në procedimet administrative, sipas ligjit për ndihmën juridike të vitit 2017, sepse të ardhurat mujore të paditësit ishin më të ulëta se sa të ardhurat minimale mujore të përcaktuara nga Qeveria.

II. MATERIALI I KËSHILLIT TË EVROPËS

A. Komisioneri për të drejtat e njeriut

31. Pas vizitës së tij në Shqipëri nga data 23 deri në 27 shtator 2013, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut (Komisioneri) shprehu shqetësime në lidhje me tarifat e tepërta gjyqësore dhe u shpreh se gjyqtarët e gjykatave të rrethit dhe të apelit duhej të kishin udhëzime të qarta, në lidhje me zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013 për çështjen në fjalë, e cila, sipas këndvështrimit të tij, mund të trajtohej nga Gjykata e Lartë në konsultim të ngushtë me Gjykatën Kushtetuese (shih Raportin e KomDH (2014)1).

32. Komisioneri vuri në dukje shqetësimet e shprehura nga Avokati i Popullit, se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk parashikonte indicie të qarta, se cila do të ishte baza ligjore për përjashtimin nga tarifat gjyqësore, duke qenë se ekzistonte një detyrim i qartë ligjor për pagesën paraprakisht të taksës së akteve dhe përjashtimet nga kjo pagesë ishin raste përjashtimore. Komisioneri iu referua një raporti tjetër në të cilin ishte konstatuar se nuk ekzistonte asnjë mundësi, që gjykatat të reduktonin tarifat gjyqësore në rrethana të veçanta, duke përfshirë edhe rastet e pamundësisë për të paguar, me përjashtim të rasteve kur personat i përkisnin një kategorie specifike,

që përjashtojë nga taksat (më konkretisht, nëse provonin se ishin përfitues të ndihmës sociale ose përmbushnin kërkesat për ta përfituar një ndihmë të tillë; ose ishin viktime të dhunës në familje ose të trafikimit të qenieve njerëzore).

33. Në shkresën vijuese të datës 11 mars 2016 (KomDH (2016)44) drejtuar ministrit të Drejtësisë të Shqipërisë së asaj periudhe, Komisioneri përsëriste shqetësimet e tij për mungesën e zbatimit efikas të ligjit për ndihmë juridike 2008, i cili vijonte të krijonte pengesa në aksesin në drejtësi për grupe të caktuara vulnerabël. Ai theksonte të metat në funksionimin e KSHNJ-së, gjë e cila vërtetohej me numrin e ulët të kërkesave për ndihmë juridike që ky komision merrte.

34. Në vijim, Komisioneri shprehte shqetësimet, se: “raportohet se gjyqtarët ngurrnin/jnë të përjashtojnë personat me vështirësi financiare nga tarifat gjyqësore. Për pasojë, pak persona janë përjashtuar nga këto tarifa”. Sipas tij, ndryshimet e vitit 2013 në ligjin për ndihmën juridike, të cilat e ngarkonin KSHNJ-në me detyrën për të bërë përjashtime në pagesën e taksës së akteve dhe nga kostot dhe shpenzimet e tjera nën disa kushte të caktuara, nuk kishin dhënë frute, duke qenë se, sipas raportimeve askush nuk kishte përfituar nga ajo mundësi.

B. Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës

35. Në raportin e ciklit të pestë monitorues për Shqipërinë, i cili trajtonte situatën në vend deri më 10 dhjetor 2014, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) shprehte shqetësimet në lidhje me mungesën e efikasitetit të sistemit për ndihmën juridike falas. Personat në nevojë për ndihmë juridike nuk kishin mundësi të paraqisnin dokumentet e nevojshme të detajuar për të aplikuar për ndihmë juridike falas pranë KSHNJ-së, i cili trajtonte një numër të vogël çështjesh në një vit, dhe buxheti i tij ishte shumë i vogël për të punësuar avokatë për të gjithë personat në nevojë.

Pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013, KERI raportonte, se: “sidoqoftë, gjyqtarët ishin ngurrues në përdorimin e pushtetit të tyre”, për të përjashtuar paditësit nga tarifa e akteve. KERI priste që gjyqtarët do të fillonin ta përdornin atë pushtet dhe ishte i mendimit se autoritetet do të duhej të garantonin se një avokat do të caktohej për paditësit me anë të sistemit të ndihmës juridike në çështjet e diskriminimit të konsideruara si urgjente.

LIGJI

1. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6§1 TË KONVENTËS

36. Kërkuesi u ankua se mosshqyrtimi i meritave të padisë së tij për dëmshpërblim nga ana e gjykatave vendëse për mospagimin prej tij të taksës së akteve përbënte një kufizim të pajustificuar të së drejtës së tij për akses në një gjykatë në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës, pjesa përkatëse e së cilës parashikon, si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë për një ... seancë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm nga [një] ... gjykatë ...”.

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

37. Qeveria parashitroi se kërkuesi nuk kishte më interes që ta ndiqte çështjen e tij përpara Gjykatës, përderisa vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit kishte qenë në favor të tij. Ai vendim konstatonte se sistemi vendës ofronte mjaftueshëm mjete, të cilat ishin efikase si në teori edhe në praktikë.

38. Gjithashtu, Qeveria parashitroi se kërkuesi nuk kishte respektuar afatin gjashtëmuor, pa dhënë asnjë detaj. Në vijim, Qeveria shprehej se ankesa ishte e parakohshme, duke qenë se kërkuesi e kishte paraqitur kërkesën në Gjykatë, përpara dhënies së vendimit nga Gjykata Kushtetuese Administrative e Apelit. Në fund, Qeveria ishte e mendimit se ankesa nuk mbështetej në fakte.

39. Kërkuesi parashitroi, se Qeveria nuk kishte deklaruar periudhën prej së cilës kishte nisur të përlogaritej afati gjashtëmuor. Në çdo rast, kërkesa e tij nuk ishte e parakohshme, fillimisht, ai e

kishte paraqitur padinë pranë gjykatave vendëse në vitin 2011 dhe, deri më sot nuk kishte marrë ende një vendim për këtë çështje. Për pasojë, sipas tij, gjykatat vendëse nuk kishin ofruar mjete praktike dhe efikase për përjashtimin e tij nga detyrimi për të paguar tarifat gjyqësore.

2. Vlerësimi i Gjykatës

40. Palët nuk debatuan për zbatueshmërinë e nenit 6 gjatë procedimeve në fjalë. Duke qenë se procedimet kishin të bënin me kërkesën e kërkuarit për dëmshpërblim dhe në këtë mënyrë lidheshin me “përcaktimin e të drejtave civile”, për qëllime të atij neni, Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të vendosur ndryshëm (shih, për shembull, *Kreuz kundër Polonisë* nr. 28249/95, §35, 19.6.2001).

41. Fillimisht, Gjykata do të adresojë objeksionin e Qeverisë, se duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit të datës 21 dhjetor 2017, kërkuari e humbi statusin e tij të viktimës dhe nuk ka më interes në ndjekjen e kësaj kërkeje përpara Gjykatës. Gjykata përcakton, se, në parim, edhe një vendim i favorshëm për një kërkuar nuk mjafton për ta privuar atë nga statusi i tij/saj i “viktimës”, sipas nenit 34 të Konventës, në rast se autoritetet kombëtare nuk e kanë njohur, shprehimisht apo në mënyrë substanciale dhe, më pas, janë korrigjuar për shkeljen e Konventës (shih, për shembull, *Scordino kundër Italisë (nr. 1)* [DHM] nr. 36813/97, §180, GJEDNJ 2006-V). Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Apelit nuk njohu mungesën e aksesit në një gjykatë të kërkuarit, por ia kaloi çështjen Gjykatës së Shkallës së Parë për të shqyrtuar kërkesën për ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga tarifa gjyqësore. Gjithashtu, për kërkuarin nuk u bë asnjë korrigjim, duke qenë se vlerësimi i rrethanave të tij personale nuk është bërë ende. Faktikisht, gjykatat vendëse nuk kanë marrë asnjë vendim në lidhje me pretendimin e kërkuarit për dëmshpërblim, pasi deri më 22 janar 2018, apelimi në kasacion i palës kundërshtare, për çështjen e ndërmjetme të shlyerjes së taksës së akteve, rezultoi të jetë ende pezull përpara Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, Gjykata është e mendimit se, për qëllime të nenit 34 të Konventës, kërkuari nuk ka humbur statusin e tij të viktimës, dhe kundërshtimi i Qeverisë, në lidhje me këtë aspekt duhet të rrëzohet.

42. Në vijim, Gjykata gjykon se, pavarësisht objeksionit të Qeverisë për respektimin nga ana e kërkuarit të afatit kohor gjashtëmuor, nuk ka dalë asnjë problematikë, në lidhje me procedimet që janë pezull përpara gjykatave vendëse. Në lidhje me kundërshtimin e Qeverisë, se ankesa ishte e parakohshme, Gjykata vëren se kërkuari paraqiti një padi për dëmshpërblim për humbjen e jetës së bashkëshortes së tij, më 21 shkurt 2011 (shih paragrafin 5 më sipër), dhe se ajo padi nuk është shqyrtuar ende në themel nga gjykatat vendëse, pavarësisht një sërë hapash të ndërmarrë nga ai në lidhje me këtë aspekt. Për sa i përket faktit se kanë kaluar më shumë se dhjetë vjet që nga dorëzimi i padisë në gjykatat vendëse, pa një vendim përfundimtar për meritat e çështjes, Gjykata mendon se kjo problematikë është edhe esenca e ankesës së kërkuarit për një kufizim të pajustificuar të së drejtës së tij për akses në një gjykatë dhe duhet t’i shtohet shqyrtimit të meritave të ankesës.

43. Gjithashtu, ankesa ngre problematika serioze, që kanë të bëjnë me faktin dhe ligjin sipas Konventës, vendimi për të cilat kërkon shqyrtimin e meritave të çështjes. Sipas nenit 35§3(a) të Konventës, ankesa nuk është e pambështetur në fakte dhe nuk është e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

a) Kërkuari

44. Kërkuari theksoi se sistemi vendës nuk ofronte mjete efikase për ankesën e tij, në lidhje me Konventën. Në këtë aspekt, vendimet e gjykatës vendëse të garantuara nga Qeveria ishin thjesht provë e pasigurisë, që shoqëronte çështjen e përjashtimeve nga taksa të akteve dhe nga kostot dhe shpenzimet në përgjithësi.

45. Kërkuesi u shpreh se ai ishte penguar që çështja e tij të shqyrtohej nga gjykatat vendëse, duke iu referuar pamundësisë së tij financiare për të paguar taksën e akteve. Faktikisht, Gjykata e Shkallës së Parë, e cila kishte njohur varfërinë e tij, e kishte pushuar çështjen duke iu referuar vetëm mospagesës së taksës. Në apelin e tij në kasacion, Ministria e Mbrojtjes nuk e kishte kundërshtuar gjendjen e varfër të kërkuesit, por kishte argumentuar se Gjykata e Shkallës së Parë kishte zbatuar dhe interpretuar në mënyrë korrekte ligjin vendës, duke mos e përjashtuar atë nga detyrimi për të paguar taksën e akteve.

46. Kërkuesi nënvizoi se kufizimi i së drejtë së tij për akses në një gjykatë kishte qenë thjesht dhe vetëm i një natyre financiare, pa pasur lidhje me meritat e padisë ose me aspektet e suksesit të saj. Gjithashtu, mungesa e një udhëzimi të qartë legjislativ dhe rregullator, në lidhje me modalitetet e garantimit të përjashtimit nga taksa e akteve, siç parashikohet në opinionin kundërshtues të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013 (shih paragrafin 25 më sipër), i bëri gjyqtarët ngurrues në pranimin e një kërkesë të tillë.

47. Në fund, kërkuesi parashtroi se, ndryshe nga pretendimet e Qeverisë se të drejtat e tij ishin garantuar me anë të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, ai nuk ishte përjashtuar ende nga detyrimi për të paguar tarifat gjyqësore. Gjykata e apelit nuk kishte vendosur ta përjashtonte nga ky detyrim, por në vend të vepronte kështu, gjykata e kishte dërguar çështjen në gjykatën e shkallës së parë me udhëzimin, që kjo gjykatë të shqyrtonte kërkesën e kërkuesit për përjashtim. Në vijim, kërkuesi parashtroi, se vonesa në shqyrtimin e meritave të padisë së tij për dëmshpërblim, e kishte bërë garantimin e së drejtës së tij për akses në gjykatë teorike dhe iluzioniste. Kjo nënkuptonte se esenca e së drejtës së tij për akses në një gjykatë ishte cenuar.

b) Qeveria

48. Qeveria theksoi se pagesa paraprake e taksës së akteve ishte imperative për të garantuar mirëfunksionimin e procesit gjyqësor dhe për t'i shërbyer interesit publik.

49. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se e drejta e kërkuesit për akses në një gjykatë ishte njohur nga gjykatat vendëse, duke qenë se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit kishte përfshirë të gjitha parimet e artikuluar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Ligji i brendshëm dhe praktika gjyqësore, duke përfshirë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013, tregonte se sistemi ofronte mjete efikase dhe se argumentimi nga ana e ankuesit se aksesit i tij në një gjykatë ishte kufizuar, për shkak të pamundësisë së tij për të paguar taksën e akteve nuk mbështetej në fakte.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet e përgjithshme

50. Gjykata thekson se e drejta për akses në një gjykatë nuk është absolute, por mund të bëhet objekt i kufizimeve; këto nënkuptohen përderisa e drejta për akses nga vetë natyra e saj kërkon rregullimin nga ana e shtetit, rregullim i cili mund të variojë në kohë dhe në vend, sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve. Kufizimet nuk duhet që të kufizojnë aksesin e mbetur për individët, në atë mënyrë apo në atë nivel, që të cenohet çdo aspekt i së drejtës. Gjithashtu, një kufizim nuk është në përputhje me nenin 6§1 të Konventës, nëse nuk ndjek një synim legjitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih *Pasquini kundër San Marinos* nr. 50956/16, §156, 2 maj 2019).

51. Gjykata ka vendosur se duke qenë se kërkesa për të paguar tarifat gjyqësore në gjykatat civile, në lidhje me paditë për të cilat këto gjykata duhet të japin një vendim, nuk mund të konsiderohet si kufizim i së drejtës për akses në një gjykatë, gjë e cila është në mosrespektim *per se* të nenit 6§1 të Konventës (shih *Stankov kundër Bullgarisë* nr. 68490/01, §52, 12 korrik 2007), shuma e tarifave të vlerësuara në bazë të rrethanave të një çështjeje të caktuar, duke përfshirë edhe mundësinë e kërkuesit për t'i paguar ato, dhe faza e procedimeve në të cilën është vendosur ky kufizim, janë faktorë të cilët janë materialë në përcaktimin nëse një person ka shijuar apo jo të drejtën e tij për

akses dhe është “... dëgjuar nga një gjykatë” (shih *Kreuz*, cituar më sipër, §60). Gjykata i kushton veçanërisht vëmendje rëndësisë së kufizimet në aksesin e një gjykate të cilat janë krejtësisht të një natyre financiare dhe që nuk lidhen aspak me meritat e padisë apo me perspektivat për suksesin e saj duhet t’i nënshtrohen një shqyrtimi rigoroz nga aspekti i interesave të drejtësisë (shih, midis të tjerash, *Podbielski dhe PPU Polpure kundër Polonisë* nr. 39199/98, §65, 26 korrik 2005; *Teltronic-CATV kundër Polonisë* nr. 48140/99, §61, 10 janar 2006; *Apostol kundër Gjeorgjisë* nr. 40765/02, §60, GJEDNJ 2006-XIV; dhe *Paykar Yev Haghtanak Ltd kundër Armenisë* nr. 21638/03, §45, 20 dhjetor 2007).

52. Gjithashtu, Gjykata i ka konsideruar si të tepruara dhe, për këtë arsye, si cenuese në esencën e së drejtës për akses në gjykatë, tarifat e larta gjyqësore, të cilat nuk justifikoheshin nga situata financiare e kërkuesit, por ishin përlllogaritur në bazë të një përqindjeje standarde statutoire të shumës në fjalë gjatë procedimeve (shih *Weissman dhe të tjerët kundër Rumanisë* nr. 63945/00, §§39–42, GJEDNJ 2006-VII (ekstrakte)).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen konkrete

53. Në çështjen konkrete, kërkuesi paraqiti një kërkesë për dëmshpërblim për humbjen e jetës së bashkëshortes së tij. Sipas ligjit vendës, atij i kërkohej të paguante një taksë aktesh, e cila përlllogaritej në bazë të një përqindjeje standarde, të përcaktuar nga ligji, për shumën e pretenduar. Gjykata nuk ka përjashtuar faktin, se qëllimi i ndjekur nga rregullat e përgjithshme për pagesën dhe mbledhjen e tarifave gjyqësore i shërben interesit të drejtësisë dhe, si i tillë, mund të pranohet të jetë në përputhshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih *Kreuz*, §59, dhe *Weissman dhe të tjerët*, §§35, të dy cituar më sipër).

54. Megjithatë, palët nuk kanë diskutuar aspektin, se, për shkak të situatës së tij të dobët financiare, si rezultat i statusit të tij si i papunë, kërkuesi nuk ka pasur mundësi të paguante taksën e lartë të akteve, e cila është njëqind e njëzet herë më e lartë se sa pensioni i tij mujor (shih paragrafët 6 dhe 7 më sipër). Aspekti qendror i kësaj çështjeje mbetet nëse autoritetet vendëse kanë bërë një vlerësim për situatën e tij financiare, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të Konventës, në mënyrë që detyrimi për të paguar taksën e lartë të akteve të mos cenonte esencën e së drejtës së tij për akses në një gjykatë.

55. Gjykata është shprehur se pala e cila kërkon të përjashtohet nga tarifat gjyqësore duhet të veprojë me kujdesin e nevojshëm, kur i paraqet gjykatave provat, në lidhje me situatën e tij/saj financiare dhe ka detyrimin të bashkëpunojë në mënyrë besnike me gjykatat për çështjen (shih, për shembull, *Elcomp sp. Z.o.o. kundër Polonisë* nr. 37492/05, §41, 19 prill 2011). Në lidhje me këtë aspekt, kërkuesi bëri kërkesë pranë KSHNJ-së, pa sukses, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Ndihmën Juridike. Kërkesa e tij për përjashtim nga taksa e akteve nuk mori përgjigje. Gjykata thekson të metat në funksionimin e KSHNJ-së që prej krijimit të saj, të meta të cilat u raportuan nga organet monitorues të Këshillit të Evropës në vitin 2013 dhe 2014 (shih paragrafët 33 dhe 35 më sipër) dhe u vunë në dukje në një shkresë dërguar kërkuesit nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2015 (shih paragrafin 12 më sipër).

56. Kërkuesi bëri edhe një kërkesë për përjashtim nga taksa e akteve në Gjykatën e Shkallës së Parë, e cila e rrëzoi kërkesën dhe ia ktheu padinë për dëmshpërblim, pa marrë një vendim mbi meritat e çështjes. Gjykata vëren, se, pavarësisht faktit se Gjykata e Shkallës së Parë kishte dokumente mbështetëse nga kërkuesi për situatën e tij të varfër financiare, kjo gjykatë, teksa e pranonte gjendjen e tij të varfër (shih paragrafin 9 më sipër), nuk bëri një vlerësim të rrethanave të tij personale, në përputhje me ato që rezultojnë në ishin parashikime të qarta të nenit 21/1, të ligjit për ndihmë juridike. Gjithashtu, gjykata rezultoi të mos ketë marrë në konsideratë interpretimin e bërë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 7/2013.

57. Në këtë aspekt, Gjykata mban në vëmendje situatën që dominon në Shqipëri, në periudhën në fjalë, për të cilën organet monitoruese të Këshillit të Evropës kanë shprehur shqetësime serioze,

duke nënvizuar, se: “gjqqtarët ngurrojnë që të përjashtojnë personat me kufizime financiare nga tarifat gjyqësore” (shih paragrafët 34 dhe 35 më sipër). Në vijim, Gjykata gjykon se shumica e taksës së akteve për t’u paguar nga kërkuesi ishte tejte e lartë, duke marrë në konsideratë pensionin mujor që ai merr (shih paragrafin 7 më sipër). Kufizimi në fjalë konstatohet që në fazën fillestare të procedimeve.

58. Pas një apelimi nga ana e kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit prishi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe e dërgoi çështjen te një trupë tjetër brenda së njëjtës gjykate, duke dhënë një sërë udhëzimesh për t’u marrë në konsideratë. Megjithatë, pas një apelimi në kasacion të paraqitur nga i pandehuri, më konkretisht Ministria e Mbrojtjes, procedimet rezultojnë të jenë pezull përpara Gjykatës së Lartë, që prej vitit 2018. Për pasojë, gjykatat vendëse nuk kanë realizuar ende një vlerësim të individualizuar të situatës financiare të kërkuesit, për të përcaktuar nëse ai duhet të përjashtohet nga taksa e akteve. Shqyrtimi i kërkesës për dëmshpërblim, sipas meritave, nuk ka nisur ende.

59. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se reagimi i kërkuesit për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga ligji vendës nuk mund të qortohet. Megjithatë, përpjekjet e tij duket se janë penguar nga efekti kumulativ i të metave në funksionimin e KSHNJ-së dhe mosmiratimit nga ana e tij të rregulloreve zbatuese, nga hezitimi i dukshëm i gjyqtarëve vendës për të përjashtuar personat, me mjete të pamjaftueshme financiare nga taksa e akteve, nga mosvlerësimi i duhur nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë e situatës së tij financiare dhe nga vonesa e madhe në procedimet e kasacionit për çështjen e ndërmjetme përpara Gjykatës së Lartë. Si rezultat, kërkuesi vijon të përballlet me pasiguri, në lidhje me perspektivën që padia e tij për dëmshpërblime paraqitur në vitin 2011 të shqyrtohet në mbështetje të meritave.

60. Aspektet e mësipërme janë të mjaftueshme për të bërë të mundur që Gjykata të arrijë në përfundimin se mosvlerësimi i vazhdueshëm i gjykatave vendëse i aspektit, nëse kërkuesi klasifikohet për përjashtim nga taksa e akteve ka cenuar thelbin e së drejtës së tij për akses në gjykatë.

61. Për këtë arsye, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë (shih, *mutatis mutandis*, *Kutić kundër Kroacisë* nr. 48778/99, §§25–26 dhe 32, GJEDNJ 2002 II) dhe konstaton se është shkelur neni 6§1 i Konventës.

III. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

62. Neni 46 i Konventës parashikon, si më poshtë:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.”.

63. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”.

A. Neni 46

64. Kërkuesi i kërkoi Gjykatës që t’i sugjeronte shtetit të paditur të tërhiqte apelimin e bërë në kasacion për të mundësuar që procedimet përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të fillonin menjëherë pas vendimit të Gjykatës. Gjithashtu, ai i kërkoi Gjykatës që t’i sugjeronte Qeverisë që të merrte të gjitha masat e nevojshme për të garantuar një gjykim të përsheptuar të meritave të padisë së tij për dëmshpërblim, duke përcaktuar afate kohore për procedimet.

65. Gjykata thekson se konstatimet për një shkelje në vendimet e saj, në thelb, janë deklarative (shih, midis autoriteteve të tjerë, *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës* (nr. 2) [DHM] nr. 32772/02, §61, GJEDNJ 2009, dhe *Ë.D. kundër Belgjikës* nr. 73548/13, §167, 6 shtator 2016). Në

përputhje me nenin 46 të Konventës, një konstatim për shkelje e vë shtetin e paditur përpara detyrimit ligjor, që jo vetëm t'u paguajë personave në fjalë shumat e caktuara për kompensim të drejtë, sipas nenit 41, por edhe të përzgjedhë, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është me vend, masat individuale për t'u miratuar në urdhrin e saj të brendshëm ligjor, për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar sa më shumë të jetë e mundur efektet (shih, midis të tjerash, *Broniowski kundër Polonisë* [DHM] nr. 31443/96, §192, GJEDNJ 2004-V; *Dybeka*, cituar më sipër, §63; dhe *Slawomir Musiał kundër Polonisë* nr. 28300/06, §106, 20 janar 2009).

66. Për sa ka të bëjë me konstatimet e mësipërme, në lidhje me rrethanat specifike të çështjes dhe nevojën për t'i dhënë fund shkeljes së nenit 6§1, dhe për sa ka të bëjë me masat individuale, Gjykata shprehet se gjykata vendëse duhet të garantojnë, me urgjencë, se do të vlerësohet klasifikueshmëria e kërkesës për t'u përjashtuar nga tarifat gjyqësore, për vonesa të tjera.

67. Sipas ligjit për ndihmën juridike të vitit 2017, i cili shfuqizoi ligjin për ndihmën juridike të vitit 2008, Gjykata nuk është e mendimit, se ka pasur nevojë për masa të përgjithshme. Zbatimi i ligjit për ndihmën juridike 2017, megjithatë, mund të bëhet objekt i shqyrtimit të Gjykatës, veçanërisht, në varësi të kapaciteteve të autoriteteve për të trajtuar kërkesat për ndihmë juridike.

B. Neni 41

1. Dëmi

68. Në pretendimet e tij paraqitur, në mbështetje të rregullës 60, të Rregullores së Gjykatës, kërkuesi argumentonte, se, në rrethanat e tij specifike, konstatimi i një shkeljeje, si kompensim i drejtë i mjaftueshëm nuk do të ishte i përshtatshëm, sepse, fillimisht, çështja pritej të qëndronte përpara Gjykatës së Lartë për një kohë të gjatë, dhe së dyti, edhe pse çështja e dhënies së tarifave gjyqësore ishte zgjidhur në mënyrë të përshpejtuar, shqyrtimi i meritave të padisë së tij për dëmshpërblim do të bëhej me vonesë duke marrë parasysh *backlog*-un (dosjet e mbetura pezull) në gjykatat vendëse të të gjitha niveleve.

69. Kërkuesi nuk paraqiti pretendime për dëm monetar, por kërkoi 10,000 euro për dëm jomonetar, pasi nuk kishte marrë kompensim nga procedimet vendëse.

70. Qeveria i kundërshtoi pretendimet e kërkesës, duke nënvizuar se nuk ishin të argumentuara.

71. Gjykata pranon se kërkuesi ka vuajtur një dëm jomonetar, i cili nuk është kompensuar mjaftueshëm nga gjetja e një shkeljeje të Konventës. Duke bërë vlerësimin e saj në një bazë të përpjestimuar, Gjykata i jep atij 7,500 euro për këtë çështje.

2. Kostot dhe shpenzimet

72. Kërkuesi pretendonte edhe 2,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendëse dhe 3,400 euro për ato të bëra përpara Gjykatës. Ai paraqiti një dokument, i cili kishte një tabelë me kostot dhe shpenzimet e bëra për përfaqësuesit e tij.

73. Qeveria parashtroi se këto pretendime ishin të tepruara dhe të pajustificuara.

74. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkuës ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet, për aq kohë sa demonstron, se këto kosto dhe shpenzime ishin të nevojshme të bëheshin dhe janë bërë faktikisht dhe janë të arsyeshme sa i përket kuantitetit. Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur një listë të plotë dokumentesh, si për shembull, fatura ose kontrata, në mbështetje të shumës në total të kostove dhe të shpenzimeve të bëra në procedimet vendëse. Megjithatë, Gjykata konstaton se, për sa u përket dokumenteve në dosjen e çështjes, ai do të duhej të kishte kosto dhe shpenzime të bëra gjatë procedimeve si përpara gjykatave vendëse edhe përpara Gjykatës. Në këtë mënyrë, në çështjen në fjalë, duke iu referuar informacioneve të vëna në dispozicion, Gjykata vendos se është e arsyeshme që kërkesës t'i jepet shuma prej 3,000 eurosh.

3. Interesi i papaguar

75. Gjykata e mendon të përshtatshme, që norma e interesit të papaguar duhet të mbështetet në normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane, shumë së cilës i duhen shtuar edhe tri pikë përqindjeje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Bashkohet* me meritat e objeksionit të Qeverisë, se ankesa ishte e parakohshme dhe *e pushon* atë, pasi ka shqyrtuar meritat.

2. *E deklaron* kërkesën të pranueshme.

3. *Gjykon* se ka pasur një shkelje të nenit 6§1 të Konventës.

4. *Gjykon*:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuessit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44§2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes së pagesës:

i. 7,500 euro (shtatë mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet, për dëmin jomonetar;

ii. 3,000 euro (tre mijë euro), plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuessit, për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur prej tre muajsh deri në shlyerje interesi të thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së vonesës në pagesë plus tri pikë përqindjeje.

5. *Pushon* pjesën tjetër të padisë së kërkuessit për kompensim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 19 tetor 2021, sipas rregullës 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

ZËVENDËSREGJISTRARE

Olga Chernishova

KRYETAR

Georges Ravarani